

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Euro e nis edhe këtë javë në rënie, shkon 91.8 lekë
ADRESA	https://lapsi.al/euro-e-nis-edhe-kete-jave-ne-renie-shkon-91-8-leke-i1093681
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:42:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:38:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3d83fc25a289c90350b0a906eb6a88763238ddf40ec7e1979727149612b8844d
TEKSTI	905517b388573cfaf708ec952009a37648dc93487a274da805c4406949322441
PAMJA	453d2d56bafa46a0cb090c0f1f804cff5cb413d348a408ce292d7d322fa3b4bd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a6e910dc02f461b72562716dbbf362f3e85b5cf5c11999d71ad16773846855e8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a6e910dc02f461b72562716dbbf362f3e85b5cf5c11999d71ad16773846855e8

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Euro e nis edhe këtë javë në rënie, shkon 91.8 lekë



LAPSI.AL • 14 SEPTEMBER 2026



Euro e ka nisur javën me rënie të mëtejshme në kursin e këmbimit me Lekun dhe ka prekur një minimum të ri historik. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, monedha europiane u këmbye sot me 91.8 lekë, niveli më i ulët i regjistruar ndonjëherë.

Leku vazhdon të thellojë rënien, që ka arritur në 5.1% që nga fillimi i vitit dhe me 5.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Duket se oferta e Euros në treg është e lartë edhe pas përfundimit të pikut të sezonit veror, në periudhën korrik-gusht. Sezoni turistik është zgjatur, i favorizuar edhe nga temperaturat e larta, duke bërë që prurjet valutore nga turistët të rriten.

Ndërkohë, zhvlerësimi i vazhdueshëm i Euros duket se po ul edhe kërkesën për monedhën europiane, të paktën për nevojat e përdorimit në transaksionet e brendshme ekonomike.

Në tërësinë e vet, prurjet e valutës në ekonominë shqiptare dhe bilanci i pagesave po shfaqin një ecuri më të mirë këtë vit.

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, për 6-mujorin 2026, deficitin e llogarisë korrente pësoi rënie, me një vlerë totale prej 361 milionë eurosh ose 40.6% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Deficiti i llogarisë korrente për 6-mujorin ka shënuar njëkohësisht nivelin më të ulët që prej vitit 2018. Ulja e deficitit ka ardhur kryesisht nga rritja e eksporteve të shërbimeve dhe nga remitancat.

Bilanci në tregtinë e shërbimeve ishte pozitiv në vlerën e afërsisht 1.79 miliardë eurove, në rritje me 12.9% krahasuar me gjysmën e parë të vitit të kaluar. Më shumë se gjysma e

ide



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

28°C

KËMBIMIEURO

91.80

aktuale

08:18

Shtatori ndez protestat/ Qytetarët rikthehen në shesh, 107 ditë mobilizim kundër qeverisë

22:18



Protestuesit i zënë pritë në rrugë Belinda Ballukut (VIDEO)



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



kontributit në sektorin shërbimeve erdhi nga turizmi, që në 6-mujorin e parë të vitit i solli ekonomisë të ardhura neto në vlerën e 957 milionë eurove, në rritje me 20% krahasuar me gjysmën e parë të vitit të kaluar.

Efekt shtesë në bilancin e përgjithshëm duket të ketë dhënë edhe rritja e fortë e investimeve të huaja direkte. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se për tremujorin e dytë 2026 vlera e investimeve të huaja direkte arriti në 741 milionë euro, në rritje me 86% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Kjo rritje u ndikua ndjeshëm nga flukse të lidhura me një projekt të rëndësishëm zhvillimi në sektorin e pasurive të paluajtshme. Për të gjithë 6-mujorin e parë, vlera e përgjithshme e investimeve të huaja direkte arriti në 1.144 miliardë euro, me një rritje prej 50% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjithashtu, politika e ndjekur nga qeveria shqiptare në vitet e fundit, me suficitet të mëdha buxhetore në pjesën dërrmuese të vitit, besohet se po ushtron një ndikim shtesë në forcimin e Lekut. Për 7-mujorin 2026, buxheti ishte në suficit në vlerën e 50.7 miliardë lekëve, në rritje me 60% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Banka e Shqipërisë vazhdon të blejë valutë me qëllim frenimin e ritmit të shpejtë të rënies së kursit të Euros, por këtë vit efektshmëria e ndërhyrjeve të saj ka qenë më e ulët.

Shifrat e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë janë bërë publike vetëm deri në fund të tremujorit të parë, kur u blenë afërsisht 140 milionë euro, shifra më e lartë e regjistruar ndonjëherë.

Shifrat e periudhës në vazhdim nuk janë bërë ende publike, por mbështetur në vlerësime të tërthorta analistët e tregut besojnë se blerjet janë rritur më tej krahasuar me të njëjtat periudha të dy viteve të mëparshme. Më herët, në periudhën 2024-2025, Banka Qendrore pati tërhequr më shumë se dy miliardë euro nga tregu, në përpjekjet e saj për ta ngadalësuar forcimin e monedhës vendase./monitor



Të kështilluara



Policia reagon për kërcënimin me vdekje ndaj Osman Stafës

Gazetari Osman Stafa ka denoncuar në polici një kërcënim me vdekje, të marrë përmes një mesazhi në rrjetet sociale...



Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa/ SafeJournalists kërkon hetim urgjent


Rrjeti SafeJournalists dënon fuqishëm kërcënimin e drejtpërdrejtë me vdekje ndaj gazetarit të News24, Osman Stafa, dhe u bërë...



Rama u pret fjalën banorëve të Poliçanit, debate me kryebashkiakun socialist dhe aktoren Egla Ceno/ Qytetarët i largohen nga takimi




Protestuesit i zënë pritë në rrugë Belinda Ballukut (VIDEO)



Pse "Çunat e Londrës" po stepen në të investuarin në Shqipëri, Daily Mail gjurmon konfiskimet



Kurti prezanton emrat e qeverisë së re të Kosovës



Vendimi i Apelit: Hiqet kafazi i xhamit për Ilir Metën në sallën e gjyqit



Kontroll blic me urdhër të SPAK-ut në sektorin ku mbahet Ergys Agasi

Kontroll blic, i urdhëruar nga SPAK, në paraburgimin e Bradasheshit në sektorin ku ndodhet i izoluar Ergys Agasi, i cili akuzohet si kreu i njëse...



Pezullohet polici që qëllloi me grusht në stomak protestuesin e prangosur

është pezulluar polici që qëllloi me grusht një protestues të prangosur gjatë paradites së sotme. Pamjet e policit qëseum...



Fundoset varka me emigrantë pranë Kretës, një i vdekur dhe 25 të zhdukur në brigjet e ishullit Gavdos

Autoritetet greke njoftojnë se një person ka vdekur dhe 25 të tjerë rezultojnë të zhdukur pasi një varkë që transp...



Rama kundër kreut të Shoqatës së Gjyqtarëve: Kurrë nuk mund të flasë një gjykatës kështu!



Tabaku: Afera KAYO godet procesin e integritetit, prek themelet e shtetit

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, analizon pasojat që, sipas saj, ka afera KAYO në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë...



Kurti bën thirrje për bashkëpunimin në zgjedhjen e presidentit të ri: Duhet të ecim përpara

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti u ka bërë thirrje drejtuesve politikë për bashkëpunim në zgjedhjen e presidentit të ri...



Berisha: Ka tension mes Ramës dhe Ballukut, shkak arrestimi i Gys Agasit

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha u pyet nga gazetarët mbi zhvillimet e fundit që lidhen me Belinda Ballukun dhe zërat se SPAK m...

Me sytë katër



11:43

Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

Matthew Exton, një ish-avokat 43-vjeçar dhe ish-prokuror lokal në Ohajo, u shpall fajtor për tentativën e vrasjes së ish-gruas ...



PAMJET/ Shoferi ishte pa ndjenja, polici jashtë detyrës ndalon makinën

11:17



A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

16:47



"Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56



VIDEO/ Batutat e Ramës me Altinin nga Peza: Ky nuk është socialist, por...

23:04

SPORT

→ Të tjerë artikuj



15:11

Carnevali: "Nuk kemi ndërmend të ndryshojmë Spallettin, ndaj Sassuolo u bënë shumë gabime"



12:48

Maran rrëfhet në intervistën e pazakontë, nga tava e dheut te gjuha shqipe "Kush e shpesh"



12:02

Kore për Diogo Jota-n për të provokuar Neves: "Shpeshoj të mos shkojnë të tjerët në kore"

Spalletti, ndaj Sassuolo's u bene shume gabime

Shqipe: "Avash-avash"

te futen pas asaj qe bene



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.